



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

UNIVERSITETI "ALDENT" TIRANË

Nr. 596 Prot.

Vlorë, 06.03.2026

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI****NDËRMJET:****UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE****&****UNIVERSITETI "ALDENT"**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** sipërfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

**&**

Universitetit "ALDENT", që ka rezidencën e tij ligjore në Rruga e Dibrës Nr. 235, Tiranë (Shqipëri), dhe NIPT K31525127B, përfaqësuar nga Rektori i Universitetit. Prof. Dr. Diana SINANI. Universiteti "ALDENT" është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 673, datë 27.09.2006, dhe i akredituar institucionalisht nga autoritetet përgjegjëse të sigurimit të cilësisë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.80/2015 «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë». Universiteti "ALDENT" ka kompetencë për të ofruar shërbime publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në disiplina të shkencave mjekësore dhe teknike, si dhe për të zhvilluar bashkëpunime me institucione akademike, shkencore dhe profesionale, brenda dhe jashtë vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### **Bien dakord**

**Për të nënshkruar një Marrëveshje Standard të bashkëpunimit të bazuar në klauzolat në vijim:**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi i marrëveshjes**

Universitetet përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshje hapësirat dhe çështjet e bashkëpunimit të ndërsjellë, si dhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj.

#### **Neni 2**

##### **Baza ligjore**

Bashkëpunimi do të ndërmerret duke pasur si subjekt disponueshmërinë e fondeve dhe miratimin e Universiteteve përmes aktiviteteve të tilla ose programeve të cilat kanë të bëjnë me:

1. Shkëmbimin e kërkimeve, mësimdhënies dhe personelit administrativ.
2. Shkëmbimin e studentëve të të gjitha niveleve.
3. Aktivitete të përbashkëta kërkimore.
4. Pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike.
5. Programe të veçanta afatshkurtra akademike.
6. Programe të zhvillimit profesional.
7. Fusha të tjera në të cilat interesi i përbashkët konkret në bashkëpunim ka lindur ndërkohë ose do të zhvillohet.

#### **Neni 3**

##### **Mënyra e Bashkëpunimit**

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, anëtarët e Universiteteve do të përcaktojnë tipin, qëllimin dhe parimet e realizimit të kësaj marrëveshjeje në një aneks të veçantë të saj.

#### **Neni 4**

##### **Detyrimet e palëve**

Secili Universitet do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

#### **Neni 5**

##### **Financimi dhe Burimet**

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje varet nga disponueshmëria e fondeve për aktivitetet e përbashkëta. Të gjitha angazhimet, detyrimet dhe shpenzimet në lidhje me projektet e aprovuara nën këtë marrëveshje do të administrohen në përputhje me çdo praktikë dhe politikë normale si dhe në përputhje me termat dhe kushtet e agjencive të fondeve për çdo universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Neni 6**  
**Respektimi i marrëveshjes**

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje Universitetet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar..

**Neni 7**  
**Mirëbesimi**

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

**Neni 8**  
**Afati i marrëveshjes**

Universitetet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse Universitetet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

**Neni 9**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

- 1.Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.
- 2.Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
- 3.Kjo marrëveshje mund të zgjidhet nëse secili prej Universiteteve paraqet 6 (gjashtë) muaj përpara një kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit partner.

PËR

PËR

UNIVERSITETIN


UNIVERSITETI "ALDENT"

"ISMAIL QEMALI" VLORE

TIRANË

REKTOR  
PROF. DR. AURELA SALIAJ

REKTOR  
PROF.DR. DIANA SINANI



Adresa /Adress: Rruga "Kososva" Skelë-Vlorë

web-site: [www.uhvlori.edu.al](http://www.uhvlori.edu.al)  
e-mail: [info@umvlori.edu.al](mailto:info@umvlori.edu.al)